



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:252572
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06199404

ARJ.nr.129/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Muhamet Rexha anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konflikt administrativ të paditësit “. K”. Sh.P.K. me seli në fshatin S., Komuna e K., sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Shabani, avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në P., me bazë juridike anulim i akteve administrative - vendimit Nr.5236/23 të datës 12.09.2023 (nr.prot. 23/1NS-V-14-TGJ-80) dhe Vendimit Nr.5236-3/23 të datës 27.09.2023, të paditurës, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të njëjtëve, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të propozuesit - paditësit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 23 Shtator 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi-propozuesi, “. K”. Sh.P.K. me seli në fshatin, S., Komuna e K., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024, REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit -propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit “.K”. SHPK me seli në Fshatin S., Komuna e K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.524/23, i datës 08.02.2024, VËRTETOHET.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës Komerciale, dhomat e shkallës së dytë, paditësi - propozuesi në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes të së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim, të: APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ndërsa të ANULOHEN Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1047/24 të datës 24.05.2024 dhe Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.Nr.524/23 të datës 08.02.2024 dhe të APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, ashtu që: SHTYHET ekzekutimi i vendimit nr.5236/23 të datës 12.09.2023 i nxjerrë nga Inspektorati pranë të paditurës Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe vendimi me nr.5236-3/23 të datës 27.09.2023, i nxjerrë nga Komisioni për rishqyrtim të ankesave pranë të paditurës ose çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së, mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të Dhomës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton me Vendimin kontestues Nr.5236-3/23 të datës 27.09.2023, të nxjerrë nga e paditura Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në P., të Komisionit për shqyrtimin e ankesave: Refuzohet Ankesa me Nr.5236-2/23 të datës 18.07.2023 të ushtruar nga operatori ekonomik, “. K”., Sh.p.k K. K - HC Prodhues i energjisë elektrike - Lokacioni S., - K.K., E.K., - Pronar dhe Vërtetohet Aktvendimi i Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit me nr.prot.5236/23 të datës 12.09.2023 dhe Ref. 23/INS-V-14-TGJ-80 të datës 12.09.2023, me të cilin vendim në pikën I., të tij urdhërohet ankuesi këtu propozuesi-paditësi që të ndërpres aktivitetin e punëve, deri sa të pajiset me Pëlqim Ujor – valid, me afat të caktuar kohor nga MMPHI-ja.

Në arsyetim të vendimit të inspektoratit ndër të tjera theksohet se: Operatori i lartë cekur për ushtrim të aktiviteteve në vazhdim, nuk posedon dokumentacion si: Pëlqim ujor - valid me afat të caktuar kohor nga ARPL-MMPHI, e cila obligohet në bazë të dispozitave ligjore të cekura në preambulë, e njëkohësisht bie ndesh me dispozitat ligjore të Ligjit për Ujërat e Kosovës Nr.04/L-147 dhe U.A Nr.03/2018. Nga konstatimi i gjendjes operatori në fjalë, me procesverbalin Nr.23/INS/TGJ/14/80 të datës 08.09.2023, i'u është shqiptuar masa-urdhri që të ndërpres aktivitetin e punëve, deri sa të pajiset me Pëlqim Ujor-valid të caktuar kohor nga Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Kundër këtyre vendimeve pala paditëse inicicion konfliktin administrativ, dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtëve.

Fillimisht Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin KA.nr.524/2023, të datës 04.12.2023, ka aprovuar si të bazuar kërkesën e propozuesit - paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve dhe e ka shtyrë ekzekutimin e tyre derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit. Ndërsa Dhomat e Shkallës së Dytë e kësaj gjykate në procedurë ankimore me aktvendimin Kom.Dh.Sh.II.nr.265/24, të datës 31.01.2024, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës MMMPH, e ka anuluar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ia ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në rivendosje, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin KA.nr.524/23 të datës 08.02.2024, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit “. K”., Sh.P.K., me seli në fshatin “S”, Komuna e K., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit Nr.5236/23 të datës 12.09.2023 (m. prot. 23/INS-V-14-TGJ-80) të nxjerrë nga Inspektorati pranë të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Vendimit 5236-3/23 të datës 27.09.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë të paditurit, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit,

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera thekson se: Me qëllim të vlerësimit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shlyerja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Po ashtu në paragrafin 6 përcaktohet se *“Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”* dhe nenit 27 par. 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale i cili përcakton se *“Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkesë për masë të përkohshme ose lehtësim tjetër urgjent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë pa dëgjim të palëve në seancë”*. Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi propozimin e paditësit, shkresat e lëndës, por edhe përmbajtjen e arsytimit të vendimit konstatoi se paditësit me datë 18.05.2016 i ishte aprovuar kërkesa lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC-S., me kapacitet instalues 1.3 MW në L. L., në segmentin nga kuota 564m deri në kuotën 550m, derisa në vitin 12.10.2018 paditësit i ishte aprovuar kërkesa për ndryshimin e vendimit të lejes ujore nga kapaciteti 1.3 MW në 3.75 MW në segmentin lumor nga kuota 571m deri në kuotën 534m. Më 11.02.2020 paditësit i ishte pezulluar përkohësisht vendimi për pëlqimin ujqor për ndryshimin e kapaciteteve, vendim i cili ishte anuluar më 05.02.2021. Ndërkaq pëlqimi mjedisor nga i padituri, ishte lëshuar më 30.01.2020. Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe plotësimin e tij, vlerësoi se janë nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, pasi që paditësi pretendimet i ka paraqitur vetëm lidhur me plotësimin e kushtit të parë të LKA-së nenit 22, se ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit; i cili vështirë do të riparohej, ndërsa paditësi nuk ka deklaruar asnjë pretendim sa i përket kërkesës ligjore se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, kushti se ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej është i bazuar pasi që të njëjtit do ti shkaktoheshin humbje financiare për të cilin qëllim ka investuar paditësi në kuadër të këtij biznesi, megjithatë gjykata rikujton se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nuk mjafton plotësimi i vetëm njërit kusht por të gjitha kushtet specifike të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Në rastin konkret paditësi nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e tij mbi të gjitha bazat dhe nuk ka arritur as ta argumentoj dhe as ta bazoj në prova se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Pretendimet e paraqitura nga paditësi lidhur me kundërligjshmërinë e aktit të kundërshtuar si dhe pretendimet tjera të paraqitura në padi, gjykata do ti shqyrtoj në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadsisë, por që këto pretendime nuk janë me ndikim me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Prandaj, gjykata vlerëson se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet specifike të përcaktuara në nenin 22 par. 2 të LKA-së, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, andaj vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vendosur në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, si në kuptim të nenit 209 paragraf 1, nën paragraf b) të LPK-së, i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, e refuzon ankesën e propozuesit - paditësit si të pa bazuar ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërteton. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, qëndrimin juridik të saj e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit, nga paditësi - propozuesi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, ashtu siç parashihet në nenin 22 të LKA-së. Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, propozuesi - paditësi nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e tij që me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur do ti sillej dëm i cili vështirë do të riparohej, e po ashtu nuk e ka bërë të besueshme pretendimin se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, se kërkesa tërësisht mbështetet në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore për të cilat gjykata do të vendos në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesë padsisë për anulimin e vendimit të kontestuar, andaj pretendimet e tij në ankesë i vlerëson si jo të vërtetuara, të pa mjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa.

Me nenin 22 paragraf 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se: *“Me kërkesën e paditësit akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 22, paragrafi 6, të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit*

administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”.

Kolegji i Gjykatës Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pas shqyrtimit të kërkesës së propozuesit - paditësit, vendimit të atakuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë dhe dhomat e shkallës së parë gjen se: gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë si në aktvendimet e tyre të apeluara, bazuar në nenin 22 të LKA-së, të cituar si më lartë, me refuzimin kërkesës/propozimit të propozuesit - paditësit nga dhomat e shkallës së parë dhe ankesës nga dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës së Komerciale si të pa bazuar, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të organit të paditur Nr.5236/23 të datës 12.09.2023 (nr. prot. 23/INS-V-14-TGJ-80) dhe Vendimit Nr.5236-3/23 të datës 27.09.2023, sepse edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi nuk e ka bërë të besueshme me prova bindëse dhe të dëshmuara që me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur do ti shkaktohej dëm i pa riparueshëm apo i cili vështirë do të riparohej, prandaj nuk provohet se në këtë rast janë plotësuar kushtet kumulative ashtu si parashihet në nenin 22 paragraf 2, të LKA-së, se cili është dëmi i pa riparueshëm, dhe a janë plotësuar edhe kushtet tjera kumulative, që shtyrja është apo jo në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar. Prandaj kjo gjykatë vendosi që kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur kundër aktvendimit të dhomës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024, ta refuzoj si të pa bazuar.

Pretendimet e propozuesit - paditësit si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: pala paditëse ka filluar punimet dhe ndërtimin e hidrocentralit dhe si rrjedhojë janë investuar me qindra mijëra euro, e cila përveç vlerës së investuar rrezikon në mënyrë esenciale tërë zhvillimin e projektit, kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe bindëse për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe për tu aprovuar kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësorë. Nga provat e ofruara nga propozuesi - paditësi përkatësisht nga ditarët ndërtimor të datës 03.10.2022 deri më 02.12.2022, është evident investimi i investitorit “. K”., në ndërtimin e Hidrocentralit HC S., mirëpo nga provat e ofruar nuk mund të vërtetohet vlera totale e investimit deri në momentin e pezullimit të punimeve, përkatësisht nuk mund të dëshmohet dëmi vështirë i riparueshëm nëse nuk aprovet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, ngase i njëjti duhet mbështetur në prova konkrete të investimit dhe dëmit real dhe konkret andaj nga propozuesi - paditësi nuk dëshmohet me fakte dhe prova bindëse për gjykatën, që me ekzekutimin e vendimit të kundërshtares së kërkesës/propozimit - të paditurës të kontestuar me padi, shtyrja e të cilit kërkohet, propozuesit - paditësit do ti shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej, e po ashtu nuk e ka bërë të besueshme pretendimin se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, ashtu si parashihet në nenin 22 paragraf 2 dhe 6 të LKA-së.

Pretendimet e tjera të paditësit-propozuesit si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor se, afati dy vjeçar tek pëlqimi ujon është afat për fillimin e punimeve sikur te leja ndërtimore e jo afat në të cilin duhet të kryhen punimet, se gjykatat nuk kanë bërë interpretimin e nenit 10, pika 6 të Udhëzimit Administrativ 03/2018 dhe se në kuptim të kësaj dispozite a janë të ligjshme vendimet e atakuara apo jo të MMPHI, se validiteti i pëlqimit ujon është valid dy vite për tu filluar punimet, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara lidhur me vendosjen për masë të përkohshme sepse ligjshmëria e vendimeve të atakuara me padi të paditurës se janë apo jo ligjor, nuk shqyrtohet në fazën e vendosjes për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtëve parashtruar në gjykatë siç parashihet në nenin 22 paragraf 6 të LKA, por ligjshmëria e tyre vlerësohet gjatë vendosjes meritore të çështjes në procedurë të rregullt sipas padisë së paditësit e cila është parashtruar së bashku me kërkesën për shtyrje ashtu siç parashihet në nenin 22 paragraf 3 të LKA.

Aktvendimet e kontestuara të gjykatave të instancave më të ulëta, nuk rezultojnë se janë të përfshirë as me shkelje procedurale të dispozitave të procedurës, të cilat propozuesi – paditësi vetëm i përmend por nuk i specifikon në kërkesën e tij. Aktvendimet e kontestuara kolegji i vlerëson se janë të drejtë dhe ligjor, të arsyetuar mjaftueshëm duke u paraqitur arsye të mjaftueshme për atë që është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes së çështjes për masë të përkohshme, sipas provave të ofruara nga propozuesi - paditësi, gjithnjë duke u kujdesur që mënyra e vendosjes për masë të përkohshme dhe arsyetimi i vendimmarrjes, mos të prejudiojë mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore. Prandaj pretendimet në këtë drejtim se vendimet e atakuara nuk janë të arsyetuar ligjërisht, nuk janë të qëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, nga ajo e vendosur si në vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, i cili është i qartë dhe i arsyetuar mjaftueshëm ligjërisht ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së, lidhur me faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga gjendja e elaboruar si më lartë Gjykata Supreme vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sipas gjendjes së fakteve të vërtetuara që kanë qenë me ndikim për refuzimin e ankesës së propozuesit - paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të organit të paditur. Në këtë çështje edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të propozuesit - paditësit.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr.129/2024, me datë 23 Shtator 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani